



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË ELBASAN

UDHËZIM I PËRGJITHSHËM

Nr.27, dt.16.02.2022

Mbi normimin e disa rregullave për kalimin administrativ të fashikujve të çështjeve penale të përfunduara

Mbështetur në ligjin nr. 97/2016 datë 06.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr.7905, dt.21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale”, i ndryshuar, udhëzimin nr.2, dt.29.12.2016 “Për organizimin dhe koordinimin e punës në prokurori” të Prokurorit të Përgjithshëm, Udhëzimin e Përgjithshëm nr.12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, infomimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan” të miratuar me Urdhërin nr.8 datë 21.01.2021 të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan,

Me qëllim :

- *Disiplinimin e veprimeve procedurale dhe administrative për dorëzimin e fashikujve të çështjeve penale të përfunduara ;*

- *Përcaktimin e rregullave të sakta dhe afateve të qarta për dorëzimin e fashikujve nga prokurorët ;*
- *Forcimin e rregullshmërisë administrative në kalimin administrativ të fashikujve të çështjeve penale të përfunduara nëpër të gjitha hallkat e prokurorisë ;*
- *Evidentimin e personit përgjegjës në rast situatë problematike ;*

UDHËZOJ :

1. Prokurorët kujdesen që të dorëzojnë fashikujt e çështjeve penale të përfunduara pranë zyrës së sekretarisë së prokurorëve, menjëherë sapo përmbyllin veprimet hetimore/procedurale të përpilimit të kërkesave/vendimeve përkatëse.
2. Prokurorët janë përgjegjës për të bërë me dije stafin administrativ, Drejtuesit e Seksioneve dhe Drejtuesin e Prokurorisë, në ato raste kur fashikulli i çështjes penale të dorëzuar, përmban disponime të natyrës urgjente apo afatet procedurale që lidhen me të drejtat e palëve në proces ose procesin e rregullt ligjor, janë drejt përfundimit.
3. Si rregull, prokurorët duhet të kujdesen që të dorëzojnë fashikullin e çështjes së përfunduar pranë zyrës së sekretarisë së prokurorëve, të paktën 5 ditë përpara përfundimit të afateve procedurale që lidhen me të drejtat e palëve në proces ose procesin e rregullt ligjor.
4. Prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të ngarkuar për hetimin e çështjes dorëzojnë pranë zyrës së sekretarisë së prokurorëve, të renditura dhe sistemuara fashikujt e çështjeve penale të përfunduara me të gjitha aktet në përbërje të tyre.
5. Kancelarja e prokurorisë pajis me regjistër të veçantë sekretaret e zyrës së sekretarisë së prokurorëve, në të cilin çdo sekretare regjistron datën dhe orën e saktë kur një prokuror/oficer i policisë gjyqësore, dorëzon fashikullin e çështjes penale të përfunduar për lidhje dhe sistemin. Ky regjistër nënshkruhet në sekretarja e marrjes në dorëzim dhe prokurori/oficeri dorëzues. Rregullshmëria e mbajtjes dhe plotësimit të këtij regjistri është përgjegjësi e sekretareve përkatëse.
6. Sekretaret e zyrës së sekretarisë së prokurorisë duhet që brenda të njëjtës ditë të përmbyllin me urgjencë dhe përparësi inventarizimin,

listimin, numërtimin, fotokopjimin dhe lidhjen e fashikujve të çështjeve penale për të cilat prokurorët kanë bërë me dije se kanë urgjencë. Nëse një fashikull i tillë është voluminoz dhe kërkon intesitet pune dhe kohë, nga kancelarja e prokurorisë merren masa për të ngarkuar më shumë se një sekretare me qëllim përmbylljen e materialit brenda afatit.

7. Fashikujt e çështjeve të tjera të përfunduara, si rregull përfundohen brenda të njëjtës ditë dhe maksimalisht brenda ditës së nesërme të punës. Nëse dita e nesërme korespondon me ditë pushimi zyrtar, sekretaret marrin masa të dorëzojnë fashikullin brenda ditës së marrjes në dorëzim prej tyre.
8. Drejtuesit e Seksioneve dhe Drejtuesi i Prokurorisë, si dhe më pas punonjësit administrativ të Zyrës së Regjistrimit, Zyrës së Protokollit dhe ftuesi i prokurorisë, marrin të gjitha masat që fashikujt e çështjeve penale për të cilat prokurorët kanë bërë me dije situatën e urgjencës procedurale, të kalojnë menjëherë në drejtim të gjykatës.
9. Me këtë udhëzim të njihen prokurorët dhe oficerët e kësaj prokurorie, kancelarja dhe punonjësit administrativ. Një kopje e këtij urdhëri i'u komunikohet nëpërmjet postës elektronike zyrtare @pp.gov.al. Ngarkohet specialisti TI-së me kryerjen e njoftimit.
10. Ky udhëzim hyn në fuqi më datë 21.02.2022 dhe publikohet në faqen zyrtare të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

DREJTUES I PROKURORISË

Kreshnik AJAZI

